

## KONTRATE

Per

**Krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " VICTORIA INVEST" sh.p.k**

Fatmir KUCI I biri I Ramadanit I dt 1972 banues ne Elbasan "Lagjia 29 Nentori"  
Rruga "Skender"

Me vullnetin e tij te lire duke qene i pranishem, ne zbatim te nenit 37 e vijues te Ligjit 7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregetate" eshte dakort te krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas kushteve te shenuara me poshte.

### Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " VICTORIA INVEST" sh.p.k e themeluar nga ortakut I vetem Z Fatmir KUCI.

1

### Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Republikes e Shqiperise, ne qytetin e Elbasani "Lagjia 29 Nentori" Rruga "Skender"

### Neni 3

Shoqeria eshte person juridik privat e cila i nenshtrohet legjislacionit shqiptar per veprimtarine tregtare qe do te zhvilloje ne Republiken e Shqiperise, ndersa agjensite dhe filialet qe mund te hapen jashte shtetit do t'i nenshtrohen legjislacionit te vendit perkates

### Neni 4

Shoqeria " VICTORIA INVEST " shpk do te ushtroje veprimtari tregtare ne keto fusha: Ndertim rrugesh nacionale, rurale te kategorise V, IV, III, II, I dhe rruge speciale (autostrada), ndertim rruge hekurudhore; Import dhe shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit si dhe hidrosanitare

### Neni 5

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te lidhe kontrata dhe do te hyje ne maredhenie me persona juridike dhe fizike, vendas dhe te huaj, ma banka dhe institucione financiare shqiptare dhe te huaja. Shoqeria ka te drejte te punesoje specialiste dhe punetore duke nenshkruar kontrata pune ne pajtim te plote me dispozitat e kodit te punes.

### Neni 6

Shoqeria do te funksionoje per nje periudhe 10 vjecare duke filluar ecja e afatit nga dita e regjistrimit ne gjykate.

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise ne para eshte 200.000 leke te depozituara teresisht ne Banken FEFAD nga ortakut I vetem I kesaj shoqerie z Fatmir Kuci.

### Neni 8

Kuotat e pjesemarjes ne kapital jane te gjitha te emertuara dhe te pandashme.  
Kuota me e vogel eshte 1000 leke.  
Cdo kuote prej 1000 leke i takon e drejte e nje vote.

### Neni 9

Te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te marin te gjitha masat per ritjen e kapitalit te shoqerise, te ruajne sekretet e veprimtarise se shoqerise dhe te dhenat qe marin ne menyre konfidenciale.

### Neni 10

Organet e shoqerise jane:

- a) asamblea e ortakeve
- b) adminisraatori i emeruar
- c) eksperti kontabel i autorizuar



### Neni 11

Asamblea e ortakeve eshte organi suprem dhe me i larte i shoqerise, ajo ka te drejte te shqyrtoje dhe te vendose per cdo ceshtje.

Duke qene se shoqeria " VICTORIA INVEST " sh.p.k perbehet veten nga ortaku I veten z Fatmir KUCI ashtu sic e parashikon edhe neni 61 I ligjit per "Shoqerite Tregetare" nr 7638 date 19.11,1992 tre paragrafet e pare te nenit 56 dhe neneve 57 deri 60 nuk zbatohen.

Ne kete rast raporti I administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore hartohen nga administratori. Ortaku I vetem miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Ortaku I vetem mund t'I delegoje kompetencat e tij. Vendimet e tij, te marra ne vend te asamblese, evidentohen ne nje regjister.

### Neni 12

Administratori I shoqeria " VICTORIA INVEST " sh.p.k I caktuar ne aktin e themelimit te kesaj shoqerie eshte ortaku I vetem I saj Z Fatmir KUCI ndersa pergjegjes teknik I punimeve eshte Z Ditar Shahin Musai i pajsur me license nr Z O484/1

Administratori perfaqeson shoqerine sipas kompetencave qe i ka dhene statuti. Administratori pergjigjet civilisht ndaj shoqerise dhe te treteve. Administratori ka pergjegjesi penale per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

### Neni 13


Asamblea e ortakeve ka te drejte te emeruje ekspert kontabel te autorizuar.

### Neni 14

Veprimtaria financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

### Neni 15

Te ardhurat neto qe realizohen pas zbritjes se shpenzimeve, te detyrimeve financiare dhe te rezerves se domosdoshme, ndahen si fitime ne forme dividendesh, ne raport me pjeset e kapitalit themeltar qe zoterojne. Fitimet mund te transferohen jashte shtetit pa asnje kufizim.



### Neni 16

Mosmareveshjet qe mund te lindin gjate zbatimit te kontrates zgjidhem me mirekuptim. Kur nuk arihet mirekuptimi ndermjet paleve ceshtjet i parashtrohen nje avokati, rekomandimet e te cilit kane vleren e nje zgjidhje paraprake. Ne rast se palet nuk jane dakort me keto rekomandime mund t'i drejtohen Gjykates se rrethit sipas dispozitave K.P.r.C.

### Neni 17

Kontrata ne pershtatje me ndryshimet e legjislacionit e te kushteve qe determinuan lidhjen e saj, mund te ndryshoje me vendim e asamblese se ortakeve. Statuti eshte pjese perberese e kontrates dhe i bashkelidhet asaj.

### Neni 18

Kontrata u perpilua ne kater kopje me fuqi juridike te njejte, nje depozitohet ne noteri, nje ne Gjykate kopja e trete depozitohet prane zyrave te tatim taksave dhe kopja e fundit ruhen ne seline e shoqerise.

Kontrata hyn ne fuqi me nenshkrimin nga ortaku dhe me rregjistrimin ne Gjykatën e rrethit Tirane.

### Ortaku Themelues

Fatmir KUCI



Republika e Shqiperise  
Doma e noterise Tirane

Nr 4205 Rep.  
Nr — Kol.

### Vertetim

Sot, me daten 02.03.2003 u paraqiten para meje Liri Gjoliq, notere ne noterine e Tiranes z Fatmir KUCI I panjohur prej, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se jashte zyrave te noterise me cilesine e ortakut te vetem ka hartuar kete kontrate per krijimin e shoqerise " VICTORIA INVEST " sh.p.k dhe me vullnetin e tij te lire e nenshkruan para meje.

Une noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

Notere  
Liri Gjoliq



STATUT  
I



shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "VICTORIA INVEST" sh.p.k

- 1) Fatmir KUCI I biri I Ramadanit I dt 1972 banues ne Elbasan "Lagjia 29 Nentori"  
Rruga "Skender"

Me vullnetin e tij te lire,ne pajtim me nenin 39 te ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare" eshte dakort te krijojne nje shoqeri me përgjegjësi të kufizuar,sipas kushteve te poshteshenuara ne kete statut te cilat perbejne dispozitat kryesore te kesaj shoqerie.

**Kapitulli 1**

Krijimi,emri,selia,qendra e veprimtarise,objekti dhe kohezgjatja e shoqerise.

**Neni 1**

Krijohet shoqeria me përgjegjësi të kufizuar " VICTORIA INVEST " sh.p.k me seli,ne qytetin e Elbasani "Lagjia 29 Nentori" Rruga "Skender"

**Neni 2**

Shoqeria ka te drejte te hapi agjensi filjale dyqane dhe magazina ne te gjitha qytetet e Shqiperise dhe jashte shtetit.

Agjensite filjalet dyqanet dhe magazinat jane pjese perberese e shoqerise,veprimtaria e tyre i nenshtrohet kontrates dhe statutit te shoqerise dhe ushtrohet brenda kufijve te kompetencave qe u ka dhene asambleja e ortakeve.

**Neni 3**

Shoqeria eshte person juridik privat,ne veprimtarine e saj i nenshtrohet legjislacionit te Republikes se Shqiperise,kontrates dhe statutit te saj.

Agjensite filjalet dyqanet dhe magazinat qe ngrihen jashte teritorit te Republikes se Shqiperise i nenshtrohen edhe legjislacionit te vendit ku jane ngritur dhe funksionojne.

**Neni 4**

Shoqeria " VICTORIA INVEST " shpk do te ushtroje veprimtari tregtare ne keto fusha:Ndertim rrugeth nacionale,rurale te kategorise V, IV,III,II,I dhe rruge speciale (autostrada),ndertim rruge hekurudhore;Import dhe shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit si dhe hidrosanitare.

**Neni 5**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe 10 vjecare duke filluar ecja e afatit nga dita e rregjistrimit ne Gjykate

**Neni 6**

#### Neni 6

Shoqeria do te lidhe kontrata dhe do te hyje ne marrveshje me persona fizike ose juridike vendas ose te huaj si dhe me banka te huaja ose shqiptare. Ajo ka te drejte te punesoje specialiste ose punetore qe nuk jane ortake, duke lidhur kontrata pune sipas legjislacionit ne fuqi

#### Neni 7

Kontrata e shoqerise " VICTORIA INVEST " sh.p.k mund te zgjidhet

- a) me plotesimin e afatit te shenuar ne kontrate dhe ne statut.
- b) me plotesimin e detyrave te vena ne kontrate.
- c) me pamundesine objektive te plotesimit te detyrave te fiksuara ne kontrate, pamundesi e cila rezulton nga vullneti i ortakut, bazuar ne rezultate ekonomiko-financiare te kesaj veprimtarie.
- d) me humbjen e 2/3 te pjeseve te kapitalit.
- f) me falimentimin e shoqerise.

Ne rastin e pare dhe te dyte kontrata zgjidhet ipso jure, ndersa per rastet e tjera kontrata zgjidhet nga asambleja e ortakëve vete ose duke ju drejtuar gjykates.

#### Kapitulli 2

Kapitali themeltar dhe ortakët e shoqerise

#### Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise ne para eshte 200.000 leke te depozituara ne Banken FEFAO

#### Neni 9

Kapitali Themeltar eshte i ndare ne kuota. Kuotat jane te emertuara dhe te pandashme. Kuota me e vogel eshte 1000 leke. Cdo kuote prej 1000 leke i takon e drejta e nje vote. Numri I kuotave fillon nga 1 deri 200. pronar I te cilave eshte ortakut I veten z Fatmir KUCI

#### Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshem ndermjet ,ne rruge trashgimie, pjestim pasurie etj.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri me vullnetin e lire te ortakut.

#### Neni 11

Ne rast se ne shoqeri do te pranohen ortake te tjere ata kane te drejte te marin pjese ne vendime dhe disponojne nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe kane derdhur. Ortaket nuk lejohen te kryejne veprime tregtare per llogari te vete ose per te tretet ne ato shoqeri tregtare qe zhvillojne te njejten veprimtari, pa pelqimin e ortakëve tjere.



### Neni 12

Ortakët mund të përjashtohen nga shoqëria kur:

- a) nuk derdhen në kohë pjesët e kapitalit themeltar me rastin e hyrjes në shoqëri .
- b) kryen edhe detyrën e administratorit të shoqërisë, pa pasur mandatin e ortakëve dhe pa u rregjistruar në librin tregtar.
- c) pa pelqimin me shkresë të ortakëve të tjerë përdorin kapitalin ose pasurinë për të nxjerrë dobi për vetë ose në favor të të tjerëve.
- d) me vendim të organeve kompetente është deklaruar i falimentuar, i ndaluar nga ligji ose i paafte.

### Kapitulli 3

Organet drejtuese të shoqërisë.

### Neni 13

Organet drejtuese të shoqërisë " VICTORIA INVEST " sh.p.k janë:

- a) asambleja e ortakëve
- b) administratori i emeruar
- c) eksperti kontabel i autorizuar

### Neni 14

Asambleja e ortakëve është organi suprem dhe më i lartë i shoqërisë, ajo ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vendosë për çdo çështje.

Duke qenë se shoqëria " VICTORIA INVEST " sh.p.k përbehet veten nga ortakët I veten z Fatmir KUCI ashtu sic e parashikon edhe neni 61 I ligjit për "Shoqëritë Tregtare" nr 7638 date 19.11,1992 tre paragrafet e parë të nenit 56 dhe nënëve 57 deri 60 nuk zbatohen.

Në këtë rast raporti I administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore hartohen nga administratori. Ortakët I vetem miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të eksperteve kontabel të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Ortakët I vetem mund t'i delegojë kompetencat e tij. Vendimet e tij, të marra në vend të asamblese, evidentohen në një regjister.

### Neni 15

Asambleja e ortakëve merr vendim për këto probleme:

- a) ndryshimet në statut ose në kontratë
- b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar.
- c) pranimi i ortakëve të rinj.
- d) tjetërsimi ose venia në hipotekë të pasurisë së paluajtshme si dhe për çdo gjë tjetër që ka të bëjë me drejtimin e shoqërisë.

### Neni 1

Administratori i shoqërisë organizon dhe drejton gjithë veprimtarinë e shoqërisë, ai ndjek sidomos këto detyra:



- Lidh kontrate ne emer te shoqerise me persona fizike ose juridike, vendas apo te huaje sipas kompetencave qe i jane dhene ne statut dhe ndjek plotesimin e tyre.
- Perfaqeson shoqerine ne Gjykate, Arbitrazh, organet shtetore, publike dhe private.
- Ndjek operacione tregtare dhe firmos dokumente qe kane te bejne me qarkullimin civil si fatura, ceqe, kambiale dhe cdo lloj dokumenti tjeter financiar ose bankar.
- Kontrollon veprimtarine e shoqerise, harton raportet e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore dhe ja paraqet per miratim asamblese se ortakeve 6 muaj para mbylljes se vitit financiar.
- Me miratim te ortakut te vetem percakton strukturen organizative te shoqerise, emerion dhe shkarkon nga detyra te punesuarit ne shoqeri, duke respektuar kerkesat e legjislacionit te punes.
- Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise, ndaj te treteve solidarisht dhe individualisht per shkelje te ligjeve te statutit dhe per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

#### **Neni 17**

Ortaku I vetem themelues I shoqerise " **VICTORIA INVEST** " sh.p.k eshte njekohesisht edhe administrator I saj ndersa pergjegjes teknik I punimeve ne aktin e themelimit eshte caktuar z Ditar Shahin Musai i pajsur me license nr Z O484/1

#### **Neni 18**

Shoqeria ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", ka te drejte te emeroje ekspert kontabel te autorizuar i cili mer pjese ne te gjitha mbledhjet e asamblese duke u njoftuar 15 dite perpara si dhe duke ju vene ne dispozicion materialin.

### **Kapitulli 4**

#### **Bilanci dhe te ardhurat**

#### **Neni 19**


Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik fitim-humbje sipas kerkesave te ligjit.

#### **Neni 20**

Te ardhurat neto qe realizohen pasi zbriten shpenzimet e tjera ligjore dhe fiskale, si dhe rezerva e domosdoshme ndahen ndermjet ortakeve ne forme dividendesh, sipas raportit te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoterojne.

#### **Neni 21**

Ortaku ka te drejte te trasferojne pjeset e fitimit qe i takon jashte shtetit pa asnje kufizim.





## Kapitulli 5

### Dispozita te pergjithshme

#### Neni 22

Shoqeria ka vulen e saj ne forme katerkendeshi ose rrethore ku jane shenuar inicialet e shoqerise dhe qyteti i Elbasanit.

#### Neni 23

Shoqeria vepron ne baze te ligjeve,statutit dhe kontrates.Asamblea ka te drejte te beje interpretimin e dispozitave te statutit dhe te kontrates gjate zbatimit te tyre ne praktike.

Per cdo ceshtje qe nuk eshte shprehur ne statut ose ne kontrate asamblea,aministratori sipas kometencave do t'i referohen ligjit te vecante qe ka qene ne fuqi ne kohen kur ka ndodhur rasti.

#### Neni 24

Shoqeria vepron si person juridik privat nga dita e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane,duke qene e detyruar qe per daten e fillimit te veprimtarise te njoftoje dhe organet tatimore.

#### Neni 25

Statuti u perpilua ne kater kopje me fuqi juridike te barabarte,nje per t'u depozituar ne noteri,nje ne Gjykate,nje ne zyren e tatimeve dhe nje kopje ruhet ne seline e shoqerise.

### Ortaku Themelues

Fatmir KUCI



Republika e Shqiperise  
Doma e noterise Tirane

Nr 42016 Rep.  
Nr — Kol.

#### Vertetim

Sot,me daten 07.08.2009 u paraqiten para meje **Liri Gjoliku**, notere ne noterine e Tiranes z **Fatmir KUCI** I panjohur prej,per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se me cilesine e ortakut te vetem jashte zyrave te noterise ka hartuar kete statut per krijimin e shoqerise " **VICTORIA INVEST** " sh.p.k dhe me vullnetin e tij te lire e nenshkruan para meje.

Une noterja e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

Notere

NOTERA  
**LIRI GJOLIKU**  
TIRANE

